



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.07.2020 (e Mërkure), Shkollën e Mesme Teknike Januz Zejnullahu në Viti”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emiri, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, Zyra Ligjore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, kryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent.Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës. Me lejoni t’i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë, shtabin emergjent, stafin mjekësor, drejtorët, këshilltarët komunal, Policinë e Kosovës, qytetarët e të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë. Para se të kalojmë në pyetjet dhe përgjigjen, ju njoftoj, njoftojm që MAPL-ja disa akte naj ka kthyer të ligjshëm e disa të paligjshëm e ku ju kame dërgua në këtë seance që ti plotesojm-ndryshojm. Jemi në kete situat unë ju lus që të rrespektojm rregulloren e kuvendit dhe sa më shpejt ta perfundojm kete seanc per faktin se si që e dimë jemi me një ambient të improvizuar dhe në keto rrethana.

z.Bekim Azizi: Sot e kemi një pike raportin e kryetarit po kerkojn që të pyetjet dhe pergjigjejet të hekën krejt nga rendi i dites dhe të fillojm më nje her me pikat tjerat të rendit të dites.

Kryesuesi z.Naim Pira: E qes në votim per miratim propozimin e Bekimit ku u votua nga të gjithë ky propozim tani propozij rendin e ditës.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendi Komunal.
2. Informatë për punën e kryetarit të komunës, për periudhën janar-qershor 2020
3. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar- qershor 2020
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregulloren për taksa , ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozimin e rregullores për ndryshimin e rregullores për Tatimin në Pronë të Komunës së Vitisë për vitin 2021.

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e proceduarave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësim ndryshimin e vendimit nr.01-110/05-370 të datës. 08.05.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Tërpezë
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit për intervistimin, vlersimin, poentimin e kandidateve të cilët kanë kurrkuar në konkurset publike për pozitat Drejtor, zv. Drejtor të shkollave fillore- mesme dhe qerdhës së fëmijeve të komunës së Vitisë .
10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave.
11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft planit komunal për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Vitisë 2020-2025
12. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të Planit Komunal i veprimit për Eficencë të Enërgjisë (PKVEE) 2019-2021.
13. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021.
14. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2019-2020 nga DKA- Viti.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm?

z.Bekim Azizi: Përshëndetje kryetar e ju të pranishëm tek rendi i ditës kisha pas një propozim që të jetë edhe miratimi i një deklarate e cila lidhet me njoftimin e aktakuzës të pa konfirmuar nga gjyqetret e procedurës paraprake ne se bashku si kuvend komunal me ju ndimu sikur të gjitha kuvendet në Kosove një deklaratat që ju kame prezantuar edhe në KPF-në kërkoj miratimin e juaj që të kemi një deklaratat të përbashkët.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mendoj që është e drejt ne si kuvend ta miratojmë një deklaratë të kësaj qështje unë si kryesues e përkrahi propozimin e Bekimit dhe tani qes në votim për miratim që të hin edhe kjo si pik e rendit të ditës, nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës me këtë propozim nga të gjithë u miratua rendit i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendi Komunal.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratuan procesverbalet.

Te nderuar këshilltar për arsyeje teknik nuk kemi pas mundësi ta dëgjojmë e ta shkruajmë procesverbalin pasi që ingjizimi i cili është bërë me daktofon nuk dëgjohe e nga kjo nuk kemi mundësi ta shkruajmë procesverbalin kërkojmë mirëkuptimin e juaj.

Ndërsa procesverbali të cilin e kane ingjizuar mjetet elektronik gjendet ne youtube edhe i njëjti përmes cd do të ruhet në dosje së bashku me këtë procesverbal.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju falënderoj për mirëkuptimin e juaj.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
